



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr. 1149/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: OE “ALFA I” SH.P.K -Lipjan, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontrates, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Rahovica Commerce” sh.p.k. –Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284-5-1-1 iniciuar nga AK - "KK Prishtinë", më datën: 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik: “ALFA I” SH.P.K -Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284-5-1-1 iniciuar nga AK - "KK Prishtinë".

II. VËRTETOHET, Vendimi i AK-së- njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284-5-1-1 iniciuar nga AK - "KK Prishtinë".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “ALFA I “ SH.P.K -Lipjan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues OE “ALFA I “ SH.P.K -Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 28.12.2020 me nr. 1149/20, kundër njoftimit për mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284-5-1-1 iniciuar nga AK - "KK Prishtinë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56.3, 59, 60, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 12.01.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

PRETENDIMI NR.1

Lidhur me pretendimin e OE “ALFA.I” SH.P.K., – ankues se: Sa i përket arsyes së AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se ne nuk i plotësojmë kriteret teknike/profesionale sepse nuk kemi dorëzuar dëshmi të pranueshme për teknikat e ndërtimitarisë.

Ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se në FDT dhe tek njoftimi për kontratë kërkesa ka qenë shumë e qartë "2 Teknike të ndërtimitarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit."

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, nën 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së sepse për këtë pretendim është marrë nga PSH vendim nr. 647/20 të datës 21.10.2020 në të cilin thuhet: Lidhur me pretendimin e OE “Rahovica Commerce” s.h.p.k. se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE “ALFA. I” i rekomanduar me kontratë në ofertën e tij ka angazhuar personel profesional : z. Bekim Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator (fasader) të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale dhe z. Muhamet Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- Fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale, Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim konstaton se OE “ALFA. I” në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit të kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të më poshtme: - 2 Teknikë të Ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo pikë e ankese është e qëndrueshme sepse OE “ALFA. I” në dokumentacionin e ofruar me ofertë për 2 Teknikë të Ndërtimtarisë ka ofruar dokumentacionin të stafit me përgatitje shkollore - “Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale”, ndërsa përgatitja profesionale është kërkuar për këtë personel profesional Shkolla e mesme teknike profili arsimor - Teknik i ndërtimtarisë të shkallës së IV-të të përgatitjes profesionale. Andaj OE “ALFA. I” me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë siç është kërkuar pasi që ky kriter ka mundur që të ndikoj që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur me profil - Teknik të Ndërtimtarisë dhe nuk kanë menduar se me kuadër tjetër mundën me e plotësuar këtë kriter të kërkuar në piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD në dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar dhe

neni 60 i LPP-se kriteri kryesor për dhënie të kontratës është që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulte.

Duke u bazuar në këto fakte ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

PRETENDIMI NR.2

Lidhur me pretendimin e OE "ALFA. I" SH.P.K., – ankues se: nuk kemi dorëzuar kontratën për z. Muhamet Demaj, ju sqarojmë se edhe kjo arsye nuk qëndron për faktin se në ofertën tonë e kemi bashkangjitur Marrëveshjen e bashkëpunimit me personin në fjalë, marrëveshje kjo e cila është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. (Bashkangjitur keni marrëveshjen).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, OE për z. Muhamet Demaj ka dorëzuar Marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt si qeshte kërkuar me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të kërkuara sipas III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE, III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme Teknike të ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Duke u bazuar në këto fakte ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

PRETENDIMI NR.3

Lidhur me pretendimin e OE "ALFA. I" SH.P.K., – ankues se: AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional 9.1&9.2 i FDT-së ku kërkesë ka qenë "2 Teknike të ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit". OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë sepse për kërkesën e njëjtë, ky OE ka dorëzuar Inxhinier të ndërtimtarisë. e këtë fakt e ka vërtetuar edhe vendimi i OSHP-së me nr. 261/20 ku pretendimi i jonë (pretendimi nr. 3) është cilësuar si i bazuar ku është konstatuar se OE "Rahovica" ka dorëzuar staf të mbivlerësuar për kërkesën në fjalë,

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së sepse për këtë pretendim është marr nga PSH vendim nr. 261/20 të datës 12.06.2020 në të cilin thuhet: Lidhur me pretendimin e OE “ALFA. I” . se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE “Rahovica Commerce” sh.p.k i rekomanduar me kontratë ka paraqitur dy inxhinier të ndërtimtarisë (z. Basret Selimi & z. Kadri Berisha), mirëpo nuk është përmbushur kërkesa e AK-së në këtë rast sepse punët e teknikeve të ndërtimtarisë duhet ti kryej tekniku e jo Inxhinieri , sepse kërkesë tjetër ka qen për inxhinier, pra janë kërkuar veçantë inxhinier e veçantë teknik të ndërtimtarisë, Paneli Shqyrtues konform Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim konstaton se OE “Rahovica Commerce” sh.p.k në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit të kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme: - 2 Teknike të ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo pike e ankese është e qëndrueshme sepse OE “Rahovica Commerce” sh.p.k në dokumentacionin e ofruar me ofertë për 2 teknik të ndërtimtarisë ka ofruar dokumentacionin për -2 inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, andaj OE “Rahovica Commerce” sh.p.k me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë siç është kërkuar pasi që ky kriter ka mundur që të ndikoj që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur teknik të ndërtimtarisë dhe nuk e kanë menduar se me kuadër tjetër (inxhinier) mundën me të plotësuar këtë kriter të kërkuar në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD në dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Duke u bazuar në këto fakte Eksperti Shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet **B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** dhe rekomandon që lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 13.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 15.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr.1149/20 TË DT.12.01.2021

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr.1 149/20 të dt. 12.01.2021 dhe në vazhdim po i japim përgjigjet lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues.

Pajtohem me konstatimin **Nr.3** të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin tonë ankimor.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.1** të ekspertit shqyrtues, në lidhje me pretendimin tonë ankimor për teknikët e ndërtimtarisë të prezantuar nga ana jonë, ku eksperti shqyrtues e ka cekur se kinse ne nuk e kemi plotësuar kërkesën e FDT-së. Konstatimi i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe nuk qëndron, për faktin se në FDT dhe tek njoftimi për kontratë kërkesa ka qenë shumë e qartë "**2 Tehnike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit.**" Pra kërkesa është shumë e qartë dhe konstatimi i ekspertit shqyrtuesit nuk qëndron, sepse askund në FDT nuk shkruan se është kërkuar Teknik i ndërtimtarisë se shkallës së IV-të, andaj përderisa nuk është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, shihet qartë se ne e plotësojmë kërkesën në lidhje me teknikët e ndërtimtarisë. Ndërsa sa i përket referimit të ekspertit shqyrtues në vendimin e OSHP-së nr.647/20 ku ne jemi konsideruar OE të papërgjegjshëm, ju sqarojmë edhe një herë se OSHP-ja nuk i ka analizuar në tërësi kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe për këtë fakt c ka marrë një vendim të tillë.

Nuk pajtohem me konstatimin **nr.2** të ekspertit shqyrtues, në lidhje me pretendimin tonë ankimor për kontratën e z. Muhamet Demaj, ku eksperti shqyrtues e ka pranuar që ne e kemi dorëzuar marrëveshjen për bashkëpunim, mirëpo e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si pjesërisht të bazuar. Përderisa eksperti shqyrtues e ka analizuar qartë ofertën tonë dhe e ka vërejtur se ne e kemi ofruar marrëveshjen për bashkëpunim me z. Muhamet Demaj, atëherë është dashur që pretendimin tonë ankimor ta cilësoj si të bazuar.

Gjithashtu në mes të konstatimeve nr. 1 dhe nr.2 të ekspertit shqyrtues ka kundërthënie, për faktin se tek pretendimi nr. 1 ankimor e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si të pa bazuar duke u thirrur në vendimin e OSHP-së se kinse ne nuk i kemi ofruar teknikët e ndërtimtarisë sipas kërkesës, sepse kinse kërkesë ka qenë që teknikët e prezantuar të jenë me shkollë të mesme teknike, profili arsimor- Teknik të ndërtimtarisë të shkallës së IV. Ndërsa tek konstatimi nr.2 eksperti shqyrtues e cek shumë qartë kërkesën e FDT-së të cilën e ka cekur shumë qartë se janë kërkuar **Teknike te ndërtimtarisë ine dy vite përvojë pune pas diplomimit**. Andaj duke u bazuar në këtë fakt vërtetohet fakti se edhe pretendimi ynë ankimor nr.1 është i bazuar dhe se ne kemi ofertuar sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria jonë dhe papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE "ALFA.I" SH.P.K., – ankues se: Sa i përket arsyes së AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se ne nuk i plotësojmë kriteret teknike/profesionale sepse nuk kemi dorëzuar dëshmi te pranueshme për teknikat e ndërtimtarisë. Ky arsyetim i AK-së nuk qëndron për faktin se në FDT dhe tek njoftimi për kontratë kërkesa ka qenë shumë e qartë "2 Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit."

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me

pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së sepse për këtë pretendim është marrë vendim PSH nr. 647/20 të datës 21.10.2020 në të cilin thuhet: Lidhur me pretendimin e OE “Rahovica Commerce” s.h.p.k. se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE “ALFA. I” i rekomanduar me kontratë në ofertën e tij ka angazhuar personel profesional : z. Bekim Demaj me përgatitje shkollë - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator (fasader) të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale dhe z. Muhamet Demaj me përgatitje shkollë - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- Fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale, Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që janë shqyrtuar konstaton se OE “ALFA. I” në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit të kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollë të më poshtme: - 2 Teknikë të Ndërtimtarisë me dy vite përvojë **pune pas** diplomimit. Andaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kjo pikë e ankese është e qëndrueshme sepse OE “ALFA. I” në dokumentacionin e ofruar me ofertë për 2 Teknik të Ndërtimtarisë ka ofruar dokumentacionin të stafit me përgatitje shkollë - “Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale “, ndërsa përgatitja profesionale është kërkuar për këtë personel profesional Shkollë e mesme teknike profili arsimor - Teknik i ndërtimtarisë të shkallës së IV-të të përgatitjes profesionale. Andaj OE “ALFA. I” me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë siç është kërkuar pasi që ky kriter ka mundur që të ndikoj që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur me profil - Teknik të Ndërtimtarisë dhe nuk kanë menduar se me kuadër tjetër mundën me e plotësuar këtë kriter të kërkuar në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD në dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE “ALFA. I” SH.P.K., se nuk kemi dorëzuar kontratën për z. Muhamet Demaj, ju sqarojmë se edhe kjo arsye nuk qëndron për faktin se në ofertën tonë e kemi bashkangjitur Marrëveshjen e bashkëpunimit me personin në fjalë, marrëveshje kjo e cila është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. (Bashkangjitur keni marrëveshjen).

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se OE për z. Muhamet Demaj ka dorëzuar Marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt siç është kërkuar me njoftimin për kontratë dhe dosjen e

tenderit te kërkuara sipas III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE, III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare:2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Duke u bazuar në këto fakte konstatojmë se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE "ALFA. I" SH.P.K., se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i përgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional 9.1&9.2 i FDT-së ku kërkesë ka qenë "2 Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit". OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë sepse për kërkesën e njëjtë, ky OE ka dorëzuar Inxhinier të ndërtimtarisë, e këtë fakt e ka vërtetuar edhe vendimi i OSHP-së me nr. 261/20 ku pretendimi i jonë (pretendimi nr. 3) është cilësuar si i bazuar ku është konstatuar se OE "Rahovica" ka dorëzuar staf te mbivlerësuar për kërkesën në fjalë,

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesa në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë, OE "Rahovica Commerce"sh.p.k i rekomanduar me kontratë ka paraqitur dy inxhinier të ndërtimtarisë (z. Basret Selimi & z. Kadri Berisha), andaj paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka plotësuar kërkesën e AK-se duke ofruar staf akoma edhe me te avancuar se kërkesa e AK-së, me ç'rast mund te konkludojm se inxhinieri ka kapacitete profesionale me te larta se sa teknike andaj OE ne fjale plotëson kërkesën e AK-se duke e tejkaluar profesionalisht kërkesën ne fjale me stafin e ofruar.

Paneli Shqyrtues konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit ku ai pretendon se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme: - 2 Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit, është i pa qëndrueshëm ky pretendim nga fakti se OE "Rahovica Commerce"sh.p.k në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit te kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ka ofruar dokumentacionin për -2 inxhinier te diplomuar te ndërtimtarisë, andaj OE "Rahovica Commerce"sh.p.k me ofertën e tij ka plotësuar kërkesën e lartcekur duke e tejkaluar atë në aspektin profesional me stafin e ofruar në proporcion me kërkesën e AK-së.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK Prishtinë”

1x1 OE – “ALFA. I” SH.P.K”.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.